



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
KOMISIONI I KONKURENCES

Nr. ____ Prot

Date 07.01.2011

V E N D I M

Nr. 169, Datë 07.01. 2011

“Mbi

autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së 100% të kuotave të shoqërisë Tirana Auto Sh.p.k nga shoqëria Auto Master Sh.a”.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e :

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Z. Koço Broka Anëtar
- Znj. Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 07. 01.2011, shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së 100% të kuotave të shoqërisë Tirana Auto Sh.p.k nga shoqëria Auto Master Sh.a.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), neni 2, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-56, 58, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit dhe mundësinë për njoftim të thjeshtuar” dhe Formulari “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

V Ë R E N S E:

I. Transaksioni dhe Përqendrimi

Transaksioni i njoftuar është realizuar me anë të “Marrëveshjes për blerjen e kuotave” të nënshkruar nga palët më datë 15 Dhjetor 2010, me objekt përftimin e kontrollit në shoqërinë Tirana Auto Sh.p.k me anë të blerjes së 100 % të kuotave nga shoqëria Auto Master Sh.a.

Përqendrimi konsiston në përftimin e kontrollit të plote nga shoqëria Auto Master sh.a.,

një shoqëri e cila është aktive ne tregun e shitjes se automjeteve te reja te markave Chrystler, Jeep dhe Dodge, te shoqërisë Tirana Auto, një shoqëri e cila është aktive ne tregun e shitjes se automjeteve te reja te markës TATA dhe Mitsubishi, me ane te blerjes se 100 % te aksioneve nga ana e bleresit.

Shoqëria Auto Master sh.a njekohesisht ka blere edhe shoqerine Hyundai Albania sh.p.k. Ky perqendrim eshte realizuar me marreveshjen per blerjen e kuotave te dates 13 dhjetor 2010, qe eshte njoftuar prane Autoritetit te Konkurrences per autorizim.

Njoftimi i përqendrimit me objekt përfitimn e kontrollit të shoqërisë Tirana Auto sh.p.k, nga Auto Master sh.a, është njoftuar në Autoritetin e Konkurrencës më datë 16 Dhjetor 2010, me shkresën Nr 516 Prot. Njoftimi i përqendrimit është bërë ne përputhje me afatin ligjor të parashikuar në nenin 12 pika 2 të Ligjit nr 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar).

Ky transaksioni sjell ndryshime mbi një bazë të qëndrueshme të kontrollit dhe në kuptim të nenit 10, pika 1 dhe 2, konsiderohet përqendrim.

Transaksioni i njoftuar është objekt kontrolli dhe duhet të autorizohet nga Komisioni i Konkurrencës, sepse përmbush në mënyrë kumulative edhe kushtin e parashikuar në pikën 1, shkronja a) dhe b) të nenit 12 të Ligjit.

II. Palët në transaksion

II.1 Auto Master sh.a në cilësinë e **Blerësit** me seli në adresën: Autostrada Tiranë-Durrës, km 12, Kashar, Tiranë, është një shoqëri e krijuar dhe që funksionon sipas legjislacionit shqiptar. Shoqëria Auto Master sh.a është pjesë e **Grupit Union** një shoqëri e krijuar dhe që funksionon sipas legjislacionit shqiptar me seli në adresën: Blv. :Zogu I”, Tiranë;

II.2 Tirana Auto sh.p.k, në cilësinë e **Shitësit** me seli në adresën: Rr. e Kavajës, Pallatet tek ish-parku i autobuzave, Pallati 5, Tiranë, një shoqëri e krijuar dhe që funksionon sipas legjislacionit shqiptar.

III. Xhiro për vitin 2009¹

Xhiro e palëve pjesëmarrëse në përqendrim **në tregun ndërkombëtar** është **xxx** .

Xhiro në **tregun e brendshëm** për vitin 2009, e ndarë sipas palëve është:

- Xhiro e Tirana Auto për vitin 2009: xxxx lek.
- Xhiro e Auto Master për vitin 2009: ka qenë rreth xxxx lek.

Duke qenë se shoqëria Auto Master sh.a, palë pjesëmarrëse në këtë përqendrim, është pjesë e “Union Grup sh.p.k”², referuar neneve 15, 16 dhe 17 të Ligjit, është marrë në

¹ Bazuar në të dhënat e bilanceve përkatës.

² Sipas ekstraktit të QKR, datë 14-12-2010, UNION GROUP është aksioneri i vetëm i kësaj ndërmarrjeje duke zotëruar 100% të 20 mijë pjesëve.

vlërësim xhiro e ndërmarrjeve pjesëmarrëse në grup që sipas të dhënave të administruara nga palët është **xxxx lek**.

Sa më lart, xhirot e shoqërive në përqëndrim plotësojnë kriteret e xhiros për autorizim nga Komisioni i Konkurrencës në bazë të neneve 12/1, 16 dhe 17 të Ligjit.

IV. Analiza e konkurrencës

IV.1 Tregu përkatës:

Referuar Udhëzimit të Komisionit të Konkurrencës, Nr. 76, datë 07.04.2008, "Për përcaktimin e tregut përkatës", si dhe mbështetur në veprimtarinë e palëve, treg përkatës do konsiderohet tregu i automjeteve të reja për konsumatorin shqiptar.

TREGU I PRODUKTIT:

Tregjet përkatëse të produktit

Një treg përkatës i produktit përfshin të gjitha ato produkte (mallra dhe/ose shërbime), të cilat shihen si të zëvendësueshëm nga konsumatori, për shkak të karakteristikave, çmimeve dhe përdorimit të paramenduar të tyre. Një treg përkatës produkti mund, në disa raste, të përbëhet nga një numër produktesh të veçanta, të cilat kanë karakteristika fizike ose teknike mjaft të ngjashme dhe janë të zëvendësueshme ndërmjet tyre.

Palët pjesëmarrëse në përqëndrim janë të përfshira kryesisht në tregtimin e automjeteve të reja për konsumatorin shqiptar.

Tregu i tregimit të automjeteve ndahet më tej duke i klasifikuar produktet sipas markave, përdorimit, karakteristikave teknike (fuqisë së motorit)

TREGU GJEOGRAFIK:

Palët e ushtrojnë veprimtarinë e shitjes së automjeteve të reja në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, i cili përcakton dhe dimensionet e tregut gjeografik.

IV.2 Konkurrentët në treg

Nëse i referohemi të dhënave mbi konkurrentët në tregun e importit dhe të tregimit të automjeteve të reja rezulton se janë rreth 45 shoqëri që ushtrojnë veprimtarinë në këtë treg.

Në këtë treg operojnë një numër i konsiderueshëm operatorësh, të cilët kanë kontrata me kompanitë ndërkombëtare që prodhojnë apo zotërojnë të drejtat e markave të ndryshme të automjeteve. Në tregun shqiptar importohen një gamë e gjërë e makinave, automjete vetura, automjete 4x4 (fuoristrada terreni), automjete furgona të tonazhit dhe madhësive të ndryshme, automjete ambulanca, ose me specifikime të ndryshme

(automjet laborator, automjet burgu) automjete të blinduara për sigurinë fizike si edhe transportin e sendeve me vlerë. Automjetet vetura përbëjnë një nga segmentet, të cilat zënë peshën më të madhe në import.

Prodhuesit ndërkombëtarë të automjeteve kanë hapur përfaqësitë e tyre konçesionare në Shqipëri, disa prej tyre, duke dhënë te drejtën për hapjen e distributorëve rajonale. Këto konçesionarë paraqesin gamën e prodhuesve si edhe krijojnë mundësitë për një shërbim servisi cilësor, me pjesë origjinale, kjo duke qënë një nga pikat e parashikuara në kontratën midis prodhuesve dhe konçesionareve.

V. Ndikimi i përqendrimit në treg

Tregu i importit dhe tregtimit të automjeteve të reja në Shqipëri karakterizohet nga një numër i madh shoqërisht të cilat kanë pjesë tregu që variojnë nga 15.46 % që ka konkurrenti më i madh (Classic) te pjesë shumë të vogla – në më pak se 1 % që kanë rreth 20 konkurrentë të tjerë.

Shoqëritë pjesëmarrëse në këtë përqëndrim kanë pjesë relativisht të vogla të tregut (respektivisht : 1 % blerësi - Auto Master dhe 0.22 % shitësi -Tirana Auto) gjithashtu meqenëse Auto Master ka blerë Hyundai Albania, pjesa e zotëruar nga kjo e fundit është 4.56 % dhe te treja shoqëritë së bashku nuk renditen ndër konkurrentët kryesorë në treg.

Duke përdorur si matës të shkallës së përqendrimit të tregut indeksin Herfindahl-Hirschman (HHI)³, rezulton se përqendrimi i realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Tirana Auto nga shoqëria Auto Master nuk e ndryshon strukturën e përqendrimit të tregut, i cili edhe pas përqendrimit mbetet jo i përqëndruar.

Për sa më sipër dhe meqenëse përqendrimi i realizuar mbi bazën e ndryshimit të qëndrueshëm të kontrollit nuk krijon pozitë dominuese në tregun përkatës pas përqendrimit, propozojmë autorizimin e përqendrimit nga ana e Komisionit të Konkurrencës.

Si konkluzion, përqendrimi i realizuar nuk sjell krijimin apo fuqizimin e pozitës dominuese të shoqërisë Auto Master Sh.a dhe nuk shfaqen shenja të kufizimit në mënyrë të ndjeshme të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar)

³ HHI para përqendrimit =747 (tregu jo i përqëndruar); HHI pas përqendrimit = 747.6 (tregu jo i përqëndruar).

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqëndrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së 100% të kuotave të shoqërisë Tirana Auto Sh.p.k nga shoqëria Auto Master Sh.a.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve pjesëmarrëse në përqëndrim.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Nenshtetues me varesi

Servete GRUDA


Anëtar

Koço BROKA


Anëtar

Rezana KONOMI


Anëtar

Nëse jemi dakort me argumentet e dërguara në paragrafin e parafundit të pikës 111. Këtu për vitin 2009 të përcaktuar në Vite të Veprimt.

Lindita MILO (LATI)


KRYETAR

Këtu për vitin 2009, në tregun e brendshëm për ndërmarrjet Tirana Auto dhe për ndërmarrjet Auto Master, nën plotësimin e kësaj dhe parashikuar në Nenin 12 të Ligjit dhe në të tilla nën kushteve për Autorizim dhe për të realizuar shpenzimet përkatëse në rastet e përgjithshme, nënq Autoritetit të Konkurrencës